

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.91, datë.27.07.2020

**“PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS SË SIPËRMARRJES/SHKËMBIMIT MIDIS
BASHKISË TIRANË DHE SUBJEKTIT MILO 2000 SH.P.K.”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; vendimit nr. 760, datë 20.12.2017 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë, të Njësisë Administrative Tiranë, të disa pronave me vendndodhje në zonat kadastrale 8250, 8240,8190, 8150”, të ndryshuar; vendimit nr. 53 datë 26.04.2018 të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e procedurës për negocimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë e Tiranës nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj”, vendimit nr. 107 datë 25.10.2019 të Këshillit Bashkiak “Për zhvillimin e pronave nr. 3/11, 3/54, 3/322, 3/484, zona kadastrale 8240, në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e marrëveshjes së sipërmarrjes/shkëmbimit midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit Milo 2000 shpk” me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kontratës së sipërmarrjes/shkëmbimit, nr. 7565 Rep, Nr. 2917 Kol, datë 20.07.2020, të nënshkruar midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit “Milo 2000” shpk, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Data e hyrjes në fuqi të kontratës do të jetë data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi, pas miratimit nga këshilli bashkiak.
3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU

RELACION

“PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË SIPËRMARRJES/SHKËMBIMIT MIDIS BASHKISË TIRANË DHE SUBJEKTIT MILO 2000 SH.P.K.”

Në zbatim të vendimit nr. 53, datë 26.04.2018, të Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e procedurës për negocimin me zhvilluesit privat që shprehin interesin që të bashkëpunojnë me Bashkinë e Tiranës nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj”, si dhe Vendimit nr. 107, datë 25.10.2019 të Këshillit Bashkiak “Për zhvillimin e pronave nr. 3/11, 3/54, 3/322, 3/484, zona kadastrale 8240, në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e marrëveshjes së sipërmarrjes/shkëmbimit midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit “Milo 2000” sh.p.k.”, Këshilli Bashkiak ndër të tjera ka miratuar procedurën dhe raportin përmbledhës të hartuar nga komisioni negociues i Bashkisë Tiranë, në lidhje me propozimin e paraqitur nga subjekti “Milo 2000” sh.p.k..

Këshilli Bashkiak, e konsideroi në interes të Bashkisë Tiranë dhënien për zhvillim të pasurive me nr. 3/11, 3/54, 3/322, 3/484, zona kadastrale 8240, në këmbim të përfitimit të 40 % të sipërfaqes ndërtimore në favor të Bashkisë Tiranë, për sipërfaqen e pronës të përfshirë në zhvillim sipas kufirit të menaxhimit të pronave përcaktuar nga Leja e ndërtimit.

Me urdhër të Kryetarit është ngritur Komisioni i posaçëm, i cili ka vlerësuar, negociuar dhe hartuar kontratën e sipërmarrjes, në përputhje me kriteret dhe kushtet e panegociueshme.

Me anë të VKB 107/2019 Këshilli Bashkiak ka miratuar kontratën e sipërmarrjes për tu lidhur ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe subjektit “Milo 2000” sh.p.k., me qëllim përfshirjen në zhvillimin e propozuar prej këtij të fundit, të pasurive të lartpërmendura, sipas modaliteteve dhe kushteve të përcaktuara në kontratë.

Me anë të memos nr.22920 prot., datë 10.07.2020 komisioni i posaçëm i negocimit i ka përcjellë për nënshkrim Kryetarit të Bashkisë kontratën e sipërmarrjes/shkëmbimit, midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit “Milo 2000” shpk.

Me anë të Autorizimit nr. 23343 prot., datë 14.07.2020 është autorizuar Z. Arbjan Mazniku, Nënkyetar i Bashkisë Tiranë, për nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes/shkëmbimit midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit zhvillues “Milo 2000” shpk, në kuadër të zbatimit të parashikimeve të vendimit nr. 107 datë 25.10.2019 , të Këshillit Bashkiak.

Në zbatim të pikës 14 të vendimit nr. 53, datë 26.04.2018, të Këshillit Bashkiak ku përcaktohet detyrimi, i Kryetarit të Bashkisë, për dërgimin për miratim në këshillin bashkiak të marrëveshjes së nënshkruar nga Bashkia Tiranë dhe zhvilluesi privat, i propozohet Këshillit Bashkiak miratimi i marrëveshjes së nënshkruar bashkëlidhur këtij relacioni. Kontrata hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të vendimit të këshillit bashkiak që e miraton atë.

Z. Aleksandër Lara

Specialist, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Z. Paolo Topuzi

Specialist, Sektorit të Makro Planifikimit

Znj. Jonida Rudaj

Përgjegjës, Sektori i Asistencës Ligjore dhe Legjislacionit

Z. Devis Agaraj

Përgjegjës, Sektori i Makro Planifikimit

Znj. Laura Deliu

Drejtor, Drejtoria Juridike

Znj. Frida Pashako

Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Z. Alban Dokushi

Drejtorja e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit

Z. Arbjan Mazniku

Zëvendësryetar i Bashkisë Tirane

Znj. Esmeralda Demiraj

Përgjegjës i Këshillit Bashkiak

Z. Behar Zeneli

Sekretar i Këshillit Bashkiak



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

Nr. _____

Tiranë, më. ____/____/ 2020

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim dhe miratim.

ZOTIT TONI GOGU
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

TIRANË

I nderuar zoti kryetar,

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim relacionin dhe projektvendimin “Për miratimin e marrëveshjes së sipërmarrjes/ shkëmbimit midis Bashkisë Tiranë dhe subjektit Milo 2000 shpk”

Me respekt,

KRYETARI

Erion VELIAJ

Konceptoi:

Specialist i SALL: A.Lara

Specialist, SMP: P.Topuzi

Pranoi:

Përgjegjës i SALL: J. Rudaj

Përgjegjës i SMP: D.Agaraj

Miratoi:

Drejtor i DJ: L. Deliu

Konfirmoi:

Drejtori i komanduar i DPPZHT: F. Pashako

Drejtor i DPJAL: A. Dokushi

Nr. i kopjeve: 3

Datë: 20.07.2020